



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme – Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

POLICIA E KOSOVËS / POLICIJA KOSOVA / KOSOVO POLICE

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
Generalna Policijska Direkcija / General Police Directorate



~ **PROJEKT** ~

Titulli i projektit: **PARANDALIMI I DHUNËS NË SHKOLLA DHE DELUKUENCËS SË TË MITURVE**

Departamenti policor: Departamenti për Operacione

Divizioni/Drejtoria/Sektori/Njësia:

DSP/DPBP/SPKDM

Rajoni: DPP

Data e fillimit: Prill 2015

Data e mbarimit: Qershor 2015

Partneri në zbatim: Drejtoritë e shkollave, DKA-të

Përfitimet: Komuniteti shkollorë

Komuniteti shkollorë

MENAXHERË TË PROJEKTIT:

Grada: Kapiten Policor

Pozita: Shef i Sektorit për Parandalim të Krimit dhe Delikuencës së të Miturve

Emri: Sebahate

Mbiemri: REXHA - KRASNIQI

e-mail: sebahate.rexha@kosovopolic.com

Telefoni lokal: +381 (0) 38 50 80 lokali: 1494

Telefoni celular: +377 (0) 44 867 444

Grada: Zyrtar Policor

Pozita: Zyrtar për Parandalim të Krimit dhe Delikuencës së të Miturve

Emri: Mentor

Mbiemri: ÇAKOLLI

e-mail: mentor.cakolli@kosovopolic.com

Telefoni lokal: +381 (0) 38 50 80 lokali: 1494

Telefoni celular: +377 (0) 44 990 560

APROVOJ

REFUZOJ

Nënshkrim Datë

Nënshkrim Datë

Major Çlirim HAJDINI

Drejtori i Drejtorisë së Policisë në Bashkësi dhe Preventivë

APROVOJ

REFUZOJ

Nënshkrim Datë

Nënshkrim Datë

Zt. Rashit QALAJ

Drejtori i Departamentit për Operacione

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Policia e Kosovës në kuadër të misionit dhe vizionit të saj në identifikimin, hetimin dhe ndjekjen e keqbërësve dhe sjelljen e tyre para drejtësisë, fokus të veçantë dhe me prioritet i jep parandalimit të veprave të ndryshme penale ku përmes këtij fokusi të parandalojmë pasojat për shoqërinë tonë të cilat mund të jenë edhe fatale.

Shkolla është më shumë se një institucion akademik, para se gjithash, shkolla është një institucion edukativo-arsimor për fëmijët tanë. Krijimi i një mjedisi të sigurt për nxënësit pa frikën nga sjelljet e dhunshme dhe jo njerëzore, është një sfidë relativisht e madhe për shoqërinë dhe para se gjithash një kusht elementar për ngritjen sigurisë dhe cilësisë së arsimit në Republikën e Kosovës.

Dhuna në shkolla (*School Bullying, në anglisht*) dhe delikuenca e të miturve në përgjithësi është një realitet i pothuajse i përditshëm për miliona nxënës të shkollave në mbarë botën. Kohën e fundit, jemi dëshmitarë të shfaqjes së disa sjelljeve jo-shoqërore apo të dhunshme të formave të ndryshme në shoqërinë tonë. Së fundmi, një perceptim është shfaqur në shoqëri ku mendohet se sjelljet e dhunshme apo dhuna në cilën do formë është bërë më e përhapur dhe e theksuar në shoqëri, duke përfshirë edhe institucionet e edukimit para-universitar të Republikës së Kosovës.

Është me rëndësi të theksohet se, dhuna në shkolla nuk manifestohet menjëherë pas një mosmarrëveshjeje në mes të nxënësve gjegjësisht bashkëmoshatarëve, mirëpo, kjo arrogancë dhe sjellje jo shoqërore përcillet me një histori në të cilën palët në konflikt kanë kaluar para kryerjes së ndonjë sulmi eventual. Tani më, me përsosmërinë e teknologjisë informative respektivisht lehtësimin e komunikimit përmes rrjeteve sociale, ka avancuar dhe në të njëjtën kohë është vështirësuar identifikimi i shkaktarëve apo historisë së konfliktit në fazat e hershme të zhvillimit e cila shpie deri tek mundësia që dhuna fizike potencialisht të manifestohet në institucionin shkollor. P.SH. Kemi raste kur, për shkak të një statusi të postuar në rrjetin social FACEBOOK përmes të cilit një grup nga një shkollë ka etiketuar një grup tjetër të bashkëmoshatarëve nga një shkollë tjetër kemi pasur përleshje të rëndë ku janë përdorur edhe mjete të mprehta.

Kjo do të thotë se, dhuna në shkolla përfshinë shumë më tepër se vetëm përdorimin e forcës fizike, mjeteve të ndryshme, thirrjeve me emra fyes (nënçmues) apo BULLYING siç njihet në anglisht, frikësimit, rrëmbimit të ushqimit dhe parave nga viktimat etj.

Nxënës të cilët janë viktimë e dhunës në shkolla mund të ndjehen “fajtorë” dhe të krijojnë perceptimin dhe besimin se e meritojnë dhunën e ushtruar ndaj tyre. Në të kaluarën, por edhe në ditët e sotme, në shoqëri dhe tradita të ndryshme, ndëshkimi fizik ka qenë dhe sipas situatës në terren ende mbetet njëra nga mënyrat për imponimin e “zgjidhjeve”, disiplinimin dhe “edukimin” e nxënësve apo nënshtrimin e tyre sipas rregullave të një grupi të caktuar nxënësish apo individësh në hapësirat shkollore.

Policia e Kosovës përmes Drejtorisë së Policisë në Bashkësi dhe Preventivë respektivisht Sektorit për Parandalimin e Krimit dhe Delikuencës së të Miturve vazhdimisht harton projekte dhe kampanja vetëdijesuese me qëllim të parandalimit të sjelljeve të dhunshme dhe delikumente në shkolla, ngritjen e vetëdijes së prindërve, mësim dhënësve dhe nxënësve rreth formave të ndryshme të dhunës të cilat mund të shfaqen ndërmjet bashkëmoshatarëve.

2. ARSYETIMI I PROJEKTIT

Problemi i dhunës dhe delikuencës në institucionet e arsimit para-universitar mund të paraqitet edhe më shpesh duke bartur me vete pasoja potencialisht serioze për fëmijët nëse nuk identifikohen me kohë indikatorët kryesor që shpijnë deri tek përdorimi i dhunës në mes të bashkëmoshatarëve.

Lirisht mund të themi se, një nga arsytet e manifestimit të dhunës në shkolla është mungesa e kulturës për raportimin e kësaj dukurie nga vet viktimat apo përjetuesit e dhunës, dëshmitarët apo personeli shkollor dhe, kur bëhet fjalë për viktimën potenciale ata, dhunën e ushtruar ndaj tyre e konsiderojnë si diçka normale me të cilën ata vetë duhet të ballafaqohen dhe të nënshtrohen.


Është me rëndësi të nënvizohet se, mos raportimi i rasteve të dhunës nga përjetuesit e dhunës apo dëshmitarët dhe personeli shkollorë, po mundëson krijimin e një perceptimi ku, tek ushtruesi i dhunës po krijohet bindja se me të vërtetë dhuna është e pranueshme dhe konsideron se dhuna ndaj bashkëmoshatarëve është alternativë e mirë për të ushtruar ndikim tek të tjerët. Do me thënë, ushtruesi i dhunës, dhunën të cilën e ushtron ndaj tjetrit e arsyeton dhe i duke krejt normale.

Derisa në anën tjetër, tek viktimat potenciale e dhunës të ushtruar nga bashkëmoshatarët, krijohet një perceptim i gabuar përmes së cilit ai apo ajo e sheh të arsyeshme dhunën e përjetuar për shkak se veten e sheh si më të paaftë, të prapambetur në shumë fusha në raport me ushtruesin e dhunës. Dhe për me tepër, viktimat e arsyeton në njëfarë forme dhunën e përjetuar dhe mendon se ai apo ajo si viktimë duhet të ndryshojë dhe t'i përshtatet kushteve dhe rregullave të atij apo asaj e cila e ushtron dhunën.

Përfundimisht, problemi i mos raportimit të dhunës së paraqitur në shkolla në cilëndo formë, është pasojë drejtpërdrejtë e trashëgimit të një mentaliteti nga regjimi dhe sistemi i kaluar okupues dhe aparati represiv policor.

Në vijim mund të shihni statistikën e incidenteve në dhe përreth shkollave si dhe krahasimin e tyre gjatë vitit 2013 dhe periudhës së njëjtë të vitit 2014 në nivel vendi:


Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej
Rastet e paraqitura 2013	34	42	40	36	32	29	13	12	44	36	49	20	387
Rastet e paraqitura 2014	79	57	52	41	46	29	8	14	38	53	63	31	511



RASTET E PARAQITURA NË SHKOLLA DHE NË AFËRSI TË TYRE GJATË VITIT 2014

Nr. Rastet e Paraqitura	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	GJITHSEJ
1 Vrasje	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
2 Lëndimi i lehtë trupor	14	14	11	8	6	4	0	0	15	12	14	9	107
3 Lëndimi i rëndë trupor	1	1	0	2	0	0	0	0	1	4	1	0	10
4 Prishje e rendit dhe qetësisë publike	5	6	9	7	4	1	0	1	5	4	6	6	54
5 Vjedhje	8	8	8	7	6	8	2	2	6	9	8	2	74
6 Vjedhje e rëndë	6	6	3	1	4	1	1	0	3	5	5	5	40
7 Posedim i substancave narkotike	1	1	3	2	2	2	0	0	0	2	1	1	15
8 Dëmtim prone	2	7	6	3	9	9	5	7	4	3	6	4	65
9 Posedim i armës së zjarrt	0	1	0	0	1	0	0	0	0	2	3	0	7
10 Posedimi armës së ftohtë	25	2	3	4	3	0	0	2	0	1	6	0	46
11 Posedim i sendeve të rrezikshme (tjera)	8	2	2	0	1	0	0	0	0	2	2	1	18
12 Zjarrëvënje	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	1	0	2
13 Tentim Vetëvrasje	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	1
14 Grabitje	0	0	1	0	0	0	0	0	1	0	0	0	2
15 Kanosje	2	4	3	1	3	2	0	1	1	4	6	2	29
16 Pengim i personit zyrtar	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	2
17 Ngacim seksual	1	0	0	1	1	0	0	0	0	1	1	0	5
18 Tjera	4	5	3	4	4	1	0	1	2	4	3	1	32
Gjithësej	79	57	52	41	46	29	8	14	38	53	63	31	511

Grafika e rasteve gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2013 - 2014



Policia e Kosovës përmes Drejtorisë së Policisë në Bashkësi dhe Preventivë respektivisht Sektorit për Parandalimin e Krimit dhe Delikucencës së të Miturve, duke zbatuar konceptin e Policimit në Bashkësi synon të kalojë nga një qasje reaktive në një qasje pro-aktive parandaluese që do të thotë se, përmes projekteve dhe aktiviteteve policore në bashkësi, të edukohet dhe sensibilizohet secili qytetarë rreth rolit që kemi si individ në përmirësimin e sigurisë në bashkësi dhe ngritjen e kualitetit të jetën dhe mirëqenies së qytetarit në fushën e sigurisë. Pjesë e pa ndashme e këtij koncepti është edhe ngritja e sigurisë në dhe përreth institucioneve të edukimit para-universitar të Republikës së Kosovës.

3. OBJEKTIVA E PROJEKTIT

Parandalimi i dhunës së shfaqur në mes të bashkëmoshatarëve në cilëndo formë dhe përmirësimi i gjendjes së sigurisë në institucionet e arsimit para-universitar.

Projekti parasheh trajnimin e 2880 nxënësve të institucioneve të edukimit para-universitar të Republikës së Kosovës duke respektuar në përpikëri përfshirjen e të dy gjinive në mënyrë të barabartë.

4. REZULTATET DHE AKTIVITETET E PROJEKTIT

Rezultatet e projektit kryesisht kanë të bëjnë me identifikimin e indikatorëve që kontribuojnë në konfliktet eventuale në mes të bashkëmoshatarëve, ngritjen e vetëdijes për adresimin gjegjësisht raportimin në fazat e hershme të zhvillimit të problemit dhe promovimin e bashkëpunimit ndër-sektorial për përmirësimin respektivisht krijimin e një ambienti të përshtatshëm mësimorë përmes ngritjes së sigurisë në institucionet e arsimit para-universitar të Republikës së Kosovës dhe sigurisë në bashkësi në përgjithësi.

Rezultatet e projektit do të përmbushen përmes zbatimit në përpikëri të aktivitetëve.

REZULTATI 1: Brengat dhe shqetësimet e nxënësve dhe personelit mësimorë rreth sigurisë në shkolla janë identifikuar;

Aktiviteti 1.1: Drejtorja e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë përmes Sektorit për Parandalim të Krimit dhe Delikucencës së të Miturve do të bëjë organizimin e tetë (8) takimeve me nxënësit dhe personelin arsimorë në shkollat që shenjtëron projekti për të diskutuar rreth brengave dhe shqetësimeve në përgjithësi në fushën e sigurisë:

1. Shkolla e Mesme e Ulët "Asim Vokshi", Prishtinë;
2. Shkolla e Mesme e Ulët "Ismail Qemajli", Prishtinë;
3. Shkolla e Mesme e Ulët "Dardania", Prishtinë;
4. Shkolla e Mesme e Ulët "Shkolla Model", Prishtinë;
5. Shkolla e Mesme e Lartë "Xhevdet Doda", Prishtinë;
6. Shkolla e Mesme e Lartë "28 Nëntori", Prishtinë;
7. Shkolla e Mesme e Lartë "Hoxhë Kadri Prishtina", Prishtinë;
8. Shkolla e Mesme e Lartë "Sami Frashëri", Prishtinë.

Takimet do të organizohen në bashkëpunim dhe bashkërendim të plotë me menaxhmentin e shkollave gjatë procesit mësimorë dhe kryesisht këto takime do të organizohen gjatë muajit Prill 2015 në ambientet gjegjësisht klasat e shkollave respektive. Në këto takime përveç nxënësve dhe personelit arsimorë do të marrin pjesë edhe zyrtarët policorë të sektorëve të cilët mbulojnë zonat e caktuara gjeografike, zyrtarët hetues të policisë nga stacionet policore përkatëse, zyrtari policor nga njësia e inteligjencës, aktivistët e Forumit Rinor të Prishtinës dhe OJQ të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.

Gjatë tetë (8) takimeve do të sigurohet nga një shihje me ujë natyral dhe nga një gotë plastike.

Aktiviteti 1.2: Pas takimeve të zhvilluara nga aktiviteti 1.1, Sektori për Parandalim të Krimit dhe Delikucencës së të Miturve do të bëjë përpilimin dhe dizajnin e raportit me të gjeturat nga paraqitja e shqetësimeve të nxënësve dhe personelit mësimorë gjatë takimeve të organizuara.

Ky raport do të shtypet dhe shpërndahet tek menaxhmenti i shkollave të përfshira në projekt, njësitet përkatëse policore, njësia e inteligjencës, Sektori për luftimin e krimeve kibernetike, njësia e trafikut rrugorë, sektorët policorë, njësinë e hetuesve të stacioneve policore, drejtoritë në nivel qendrorë i PK-së.

Shtypja dhe shpërndarja e raportit me të gjeturat nga takimet me nxënës do të bëhet në mesin e muajit Prill 2015.

REZULTATI 2: Publikimi i broshurave informuese rreth dhunës në shkolla dhe adresimin e saj;

Aktiviteti 2.1: Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë përmes Sektorit për Parandalim të Krimit dhe Delikuencës së të Miturve do të përpilojë tekstin e broshurave informuese për nxënësit e shkollave që janë në shënjestrën e projektit.

Tekstet e broshurave informuese do të kenë karakter sensibilizues për nxënësit rreth çështjeve gjegjësisht brengave dhe shqetësimeve të cilat tashmë janë të njohura nga analiza e situatës së sigurisë në shkolla e cila është e përshkruar në projekt dokument respektivisht në kapitullin 1. Përmbledhje Ekzekutive dhe 2. Arsyetimi i Projektit.

Përpilimi i tekstit për broshurat informuese do të finalizohet brenda muajit Prill 2015.

Aktiviteti 2.2: Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë përmes Sektorit për Parandalim të Krimit dhe Delikuencës së të Miturve në bashkëpunim me Zyrën për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun respektivisht Njësinë e Dizajnit dhe Web-faqes në kuadër të Policisë së Kosovës do të bëjë dizajnin vizual të broshurave.

Broshurat të cilat do të dizajnohen, do të adresojnë fushën e dhunës fizike, dhunës kibernetike respektivisht keqpërdorimit të rrjeteve sociale të komunikimit, keqpërdorimit të fëmijëve, vjedhjeve në shkolla ndërmjet bashkëmoshatarëve, sigurisë në trafik dhe konceptit të policimit në bashkësi.

Gjithsej do të përpilohen dhe dizajnohen gjashtë (6) broshura informuese për nxënësit.

Broshurat do të përpilohen dhe shtypen me ngjyra vetëm në gjuhën shqipe. Numri i broshurave me ngjyra që do të shtypen do të jetë për: **8 shkolla * 60 nxënës * 6 broshura për secilin nxënës = 2880 broshura.**

Shtypja e këtyre broshurave do të financohet nga buxheti i Policisë së Kosovës i planifikuar në planin e punës për vitin 2015.

REZULTATI 3: Vetëdije e ngritur tek nxënësit dhe personeli arsimorë në parandalimin e dhunës dhe raportimin e saj në fazat e hershme të zhvillimit;

Aktiviteti 3.1: Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë përmes Sektorit për Parandalim të Krimit dhe Delikuencës së të Miturve do të bashkëpunojë dhe bashkërendojë aktivitetet me DRP-në Prishtinë gjegjësisht me Stacionet policore (Qendra, Jugu dhe Veriu) respektivisht me sektorët policorë në kuadër të këtyre stacioneve në identifikimin e ligjëruesve me përvojë dhe profesional.

Gjatë këtyre takimeve do të ndahen temat të cilat do të ligjërohen nga zyrtarët policorë të sektorëve. Temat që do të ligjërohen kanë të bëjnë me:

1. Njohja e nocioneve rreth dhunës e cila paraqitet në forma të ndryshme;
2. Delikuenca e të miturve;
3. Parandalimi i përdorimit të substancave narkotike (pasoja shëndetësore dhe ligjore nga përdorimi dhe posedimi i substancave narkotike);
4. Parandalimi i keqpërdorimit të fëmijëve;
5. Parandalimi i keqpërdorimit të teknologjisë informative respektivisht rrjeteve sociale të komunikimit;
6. Masat që duhet ndërmarrë nxënësit për ngritjen e sigurisë në trafik;
7. Koncepti i Policimit në Bashkësi – përfitimet e bashkësisë, rëndësia e bashkëpunimit të nxënësve me organet e shkollës dhe policinë dhe evitimi i pasojave serioze për nxënësit përmes raportimit të rasteve apo konflikteve potenciale në mes të bashkëmoshatarëve.

Takimet bashkërenduese në mes të akterëve të Policisë së Kosovës do të organizohen në mesin e muajit Prill në ambientet e sektorëve përkatës.

Aktiviteti 3.2: Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë përmes Sektorit për Parandalim të Krimit dhe Delikuencës së të Miturve do të organizojë takime me menaxhmentin e shkollave të cilat shenjtëron projekti rreth bashkërendimit të ligjëratave respektivisht të përpilimit të orarit ligjërues në shkollat respektivë.

Me qëllim të evitimit të pengimit të procesit të rregullt mësimorë, me menaxhmentin e shkollave do të gjejmë mundësinë që tetë (8) temat që do të ligjërohen, të mbulohen brenda 5 orëve mësimore për një ditë.

Për zhvillimin e këtyre temave, në bashkëpunim me menaxhmentin e shkollave do të gjendet një sallë në të cilën do të marrin pjesë nga 4 nxënës nga secila klasë dhe të cilët do të ndjekin ligjëratat gjatë tërë ditës respektivisht 5 orë mësimore. Për vijimin e këtyre ligjëratave nga një shkollë do të marrin pjesë rreth 60 nxënës dhe personel arsimorë.

Personeli arsimorë në konsultim me menaxhmentin e shkollës do të bëjë përzgjedhjen e nxënësve të cilët do të marrin pjesë në ligjëratat.

REZULTATI 4: Ligjëratat rreth temave të parapara në aktivitetin 3.1 janë mbajtur me sukses;

Aktiviteti 4.1: Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë përmes Sektorit për Parandalim të Krimit dhe Delikuencës së të Miturve do të bashkëpunojë dhe bashkërendojë aktivitetet me Drejtorinë e Komunikacionit Rrugorë, Sektorin për Luftimin e Krimeve Kibernetike dhe Sektorin për parandalimin e Drogave për mbajtjen e ligjëratave për temat e parapara me projekt nga aktiviteti 3.1.

Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë përmes Sektorit për Parandalim të Krimit dhe Delikuencës së të Miturve në bashkëpunim me menaxhmentin e shkollave do të caktojë orarin e ligjëratave për secilën shkollë *(orari do të bashkëngjitet si aneks i projekt dokumentit, mirëpo potencialisht presim që zyrtarisht ligjëratat të fillojnë dhe të përfundojnë në muajin Maj 2015 në të gjitha shkollat e parapara me projekt).*

Para fillimit të ligjëratave, të gjithë nxënësve të përfshirë në projekt do t'u shpërndahen fletore me logo të Policisë së Kosovës dhe nga një laps kimik (2880 fletore dhe 2880 lapsa kimik).

Temat do të ligjërohen nga:

- ❖ Temat **1, 2, 4** dhe **7** do të ligjërojnë zyrtarë nga Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë;
- ❖ Temën **3** do ta ligjërojnë zyrtarë nga Sektori për parandalimin e substancave narkotike;
- ❖ Temën **5** do ta ligjërojë zyrtari nga Sektori për Luftimin e Krimeve Kibernetike;
- ❖ Temën **6** do ta ligjërojë zyrtari nga Drejtoria e Komunikacionit Rrugorë.

Kohëzgjatja e ligjërimit të temave:

- ✓ Ligjërimit i temave 1 dhe 2 do të zgjasë një (1) orë mësimore;
- ✓ Ligjërimit i temës 3 do të zgjasë një (1) orë mësimore;
- ✓ Ligjërimit i temës 4 do të zgjasë një (1) orë mësimore;
- ✓ Ligjërimit i temës 5 do të zgjasë një orë (1) mësimore;
- ✓ Ligjërimit i temave 6 dhe 7 do të zgjasë një (1) orë mësimore.

Sektorët respektivë nga Policia e Kosovës duhet të sigurohen në përgatitjen e prezantimeve dhe se të gjitha temat e parapara me projekt duhet të prezantohen përmes prezantimeve në PowerPoint të mbështetura me mjetet ndihmëse audio-vizuale (LapTop dhe Projektor, FliChart etj).

Prezantimet e përgatitura duhet të dërgohen në Drejtorinë e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë respektivisht tek menaxherët e projektit jo më vonë se java e fundit e muajit Prill 2015.

Kryesisht temat që do të ligjërohen duhet të përmbajnë material atraktiv për nxënësit të cilëve do t'u ligjërohen temat nga aktiviteti 3.1 përmes ushtrimeve, ndonjë filmi apo spoti të metrazhit të shkurtër, apo përmes demonstrimeve ilustrative dhe shembujve konkret nga rastet në praktikë.

Në fund të ligjërimeve, nga ligjëruesit dhe nga menaxherët e projektit, tek nxënësit dhe pjesëmarrësit tjerë në ligjëratat do të shpërndahen broshurat e shtypura rreth parandalimit të dhunës dhe adresimin e saj si dhe do të realizohet fotoja e përbashkët me të gjithë nxënësit pjesëmarrës në ligjëratat dhe ligjëruesit në këtë projekt.

REZULTATI 5: Publikimi i raportit final të zbatimit të projektit;

Aktiviteti 5.1: Pas zbatimit të projektit, Drejtoria e Policisë në Bashkësi he Preventivë do të hartojë dhe dizajnojë raportin final nga zbatimi i projektit.

Raporti do të përmbajë sfidat dhe vështirësitë gjatë fazave të zbatimit të projektit si dhe do të pasqyrojë sukseset dhe mësimet e mësuara nga zbatimi i projektit.

Raporti final i zbatimit të projektit do të shtypet në 20 kopje me ngjyra.

5. MODALITETET E ZBATIMIT TË PROJEKTIT

Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë përmes Sektorit për Parandalim të Krimit dhe Delikuencës së të Miturve është bartëse e projektit në nivel qendrorë të Policisë së Kosovës.

Sektorit për Parandalim të Krimit dhe Delikuencës së të Miturve në Sektorit për Parandalim të Krimit dhe Delikuencës së të Miturve në bashkëpunim me drejtorët e shkollave do të organizojnë takimet me nxënës të parapara me aktivitetin 1.1 të projektit.

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun përmes Njesisë së Dizajnit dhe Web-faqes do të përkrahë projektin duke dizajnuar vizualisht broshurat rreth dhunës në shkolla dhe adresimin e saj në fazat e hershme të zhvillimit, broshura këto të cilat do të shtypen dhe shpërndahen tek nxënësit e shenjësuar të projektit.

Drejtori, Sektorë dhe Njësi brenda Policisë së Kosovës në mënyrë të sigurtë dhe profesionale do të ndihmojnë në zbatimin me sukses të këtij projekti përmes përgatitjeve dhe ligjërimeve të temave të parapara me projekt.

Menaxhmenti i shkollave të përfshira në projekt në mënyrë efikase do të bëjnë përzgjedhjen e nxënësve të cilët do të jenë pjesë e projektit.

6. QËNDRUESHMËRIA E PROJEKTIT

Fillimisht, projekti do të zbatohet në tetë (8) shkollat e potencuara në aktivitetin 1.1 në cilësinë e pilot projektit. Më pas, në bazë të analizave nga zbatimi i projektit, mësimet e mësuara dhe kontributet dhe komentet e pranuar nga bashkëpunëtorët në kuadër të Policisë së Kosovës dhe pjesëmarrësit respektivisht nxënësit do të avancohet projekti dhe do të lancohet në zbatim gradual edhe në institucionet e tjera të arsimit para-universitar në tërë territorin e vendit.

Për më tepër, pas realizimit të këtij pilot projekti, të gjitha Rajonet Policore të Policisë respektivisht sektorët policorë do të pranojnë të gjitha raportet nga ky projekt si dhe materialin për ligjërime i cili do të përgatitet nga zyrtarët e PK-së në disiplina të ndryshme. Dhe më pas, me përkrahjen e Drejtorisë së Policisë në Bashkësi dhe Preventivë, projekti do të vazhdojë të zbatohet nga vet sektorët policorë nëpër DRP.

Gjithashtu, posterët e Policisë së Kosovës të cilët kanë karakter vetëdijësues përmes përmbajtjes dhe mesazheve bashkëpunuese do të vendosen në hapësirat e brendshme dhe të jashtme të shkollave të përmendura në aktivitetin 1.1 të projektit.

Situata e sigurisë në shkolla do të vazhdojë të monitorohet nga zyrtarët policorë të caktuar me punë në sektorë policorë dhe të cilët në të njëjtën kohë do të vlerësojnë përmirësimin e perceptimeve të nxënësve për Policinë e Kosovës dhe sigurinë në shkolla në përgjithësi.

7. DUKSHMËRIA APO VIZIBILITETI

Përmes zbatimit të projektit, Policia e Kosovës do të përfaqësohet më zyrtarë të zellshëm dhe profesional qoftë gjatë ligjëratave apo edhe në komunikim me nxënësit e tjerë jashtë shënjestrës së projektit.

Gjithashtu, përveç se logoja e Policisë së Kosovës do të jetë e ekspozuar krahas prezantimeve nga ligjëruesit e PK-së brenda dhe jashtë hapësirave shkollore do të vendosen posterë me mesazhe bashkëpunimi nga Policia e Kosovës.

Aktivitetet e ndërmarra të cilat dalin nga projekti të ilustruara përmes fotografive do të publikohen në web-faqen zyrtare të Policisë së Kosovës si dhe në faqen zyrtare në rrjetin social të komunikimit FACEBOOK.

Projekti i paraqitur përmes fotografive do të promovohet edhe në vitrinat informuese të Policisë së Kosovës (*pranë DRP Prishtina dhe pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë*).

Gjithashtu, Policia e Kosovës përmes këtij projekti do të promovohet përmes artikujve të botuar në revistën e Policisë së Kosovës "MBROJTËSI" si dhe të njëjtët artikuj do të botohen edhe në revistën mujore "ForYou" të KFOR-it e cila shpërndahet falas në të gjitha institucionet e arsimit para-universitar të Republikës së Kosovës.

7. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ZBATIMIT TË PROJEKTIT

Monitorimi i aktiviteteve të projektit do të realizohet nga Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë respektivisht drejtori i kësaj drejtorie dhe menaxherët e projektit.

Për secilin takim të zhvilluar me qëllim të zbatimit të projektit respektivisht arritjes së objektivës së tij do të përpilohen raporte të sakta dhe precize.

Meqenëse pjesë e projektit në mënyrë të drejtpërdrejtë do të jenë të përfshirë edhe menaxherët e tij, atëherë edhe monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të projektit do të jetë i drejtpërdrejtë.

Pas zbatimit të aktiviteteve të parapara me projekt, do të hartohet dhe dizajnohet një raport i detajuar me sfidat, vështirësitë dhe sukseset në përmbushjen e rezultateve gjegjësisht objektivit të projektit në përgjithësi.

Raporti vlerësues i projektit do të përpilohet dhe shpërndahet brenda muajit Qershor 2015.

8. ARANZHIMET DHE NEVOJAT TJERA PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT

Njësitë mbështetëse	Përshkrimi i mënyrës së mbështetjes	Datë
<input checked="" type="checkbox"/> Financat	Alokimi i mjeteve financiare për blerjen e ujit natyral gjatë takimeve dhe gotave të plastikës, alokimimi i mjeteve financiare për shtypjen me ngjyra të broshurave informuese për nxënësit rreth dhunës në shkolla dhe adresimit të saj dhe alokimimi i mjeteve financiare për shtypjen e raporteve të cilat dalin nga projekti.	Prill - Qershor 2015
<input type="checkbox"/> <i>Prokurimi</i>		
<input type="checkbox"/> <i>DTIK</i>		
<input checked="" type="checkbox"/> <i>Logjistika (udhëtime/telefona)</i>	Sigurimi i fletoreve dhe lapsave kimik me logo të Policisë së Kosovës. 2880 copë fletore dhe lapsa kimik.	Maj 2015
<input type="checkbox"/> <i>Shërbimet ligjore</i>		
<input checked="" type="checkbox"/> <i>Informimi Publik</i>	Publikimi i aktiviteteve të projektit në web-faqen zyrtare të PK-së dhe në rrjetin social FACEBOOK të PK-së si dhe publikimi i artikujve në revistën e Policisë së Kosovës "MBROJTËSI".	Prill - Qershor 2015